



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	20/DPK
Nr. flet Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-4532/15
Data Datum Date	01-12-2015
PRISTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-3440-15 për z.Imri Vishi-Kryeshef i Spitalit Rajonal Ferizaj, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-3440-15, për Zyrtarin e lartë, z.Imri Vishi-Kryeshef i Spitalit Rajonal Ferizaj, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Vishi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Vishi është deklaruar se brenda afatit ligjor, do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-02-4440/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilën shihet se te bizneset individuale N.SH.“Poliklinika Specialistike mjeksore VISHI”, z.Vishi tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



Hasan Preteni